

## VENDIM Nr. 1

### I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE ORTAKVE TE SHOQERISE “TIRANA EYE CLINIC” sh.p.k

Sot, ne Tirane, me daten, 16.03.2021 ne seline e saj, ne Rr. Dibres , Tirane e rregjistruar ne QKB me NIPT **M01421019D** u mblohd Asambleja e Zakonshme e Ortakve te shoqerise “**TIRANA EYE CLINIC**” sh.p.k. sipas lajmerimit te bere regullisht per ndryshimin e pershkrimit te aktivitetit te kompanise .

Ne mbledhje moren pjese:

1- Z. Albert Lula , zoterues i 100 % te kapitalit themeltar

Rendi i dites:

Ndryshimi i Pershkrimit te Aktivitetit

- **Nga :** “Kryerjen e konsultave oftalmologjike, diagnostikime te patologjive oftalmike ku perfshihen: patologjite korneale dhe glaucoma, patologjite retinale dhe neuro-oftalmologjia, patologji te oftalmologjise pediatrike dhe okuloplastika. Gjithashtu do te kryhet ekzaminimi dhe trajtimi i anomalive rekraktive, korrigjim me syze, lente kontakti (te buta ose rigide), injesione intravitreale, dhe injeksione peri/retrobulbare, perdorimi i Cross-Link (CXL). Do te kryhen ekzaminime imazherike si: autorefraktometria dhe biomikroskopia, topografia korneale, microperimetria, tomografia retinale, Eko A/B dhe Angiografia me Fluoresceine. Do te kryhen nderhyrje kirurgjikale me anestezi topikale per trajtimin e kataraktes, pterygiumit dhe chalasion ose me anestezi gjenerale per trajtimin e obstruksioneve te duktusit nazolakrimal. Do te mundesoje hapjen e klinikave oftalmologjike dhe laboratoreve optike; gjithashtu, import-eksport te pajisjeve mjeksore, medikamenteve mjeksore, skeleteve te syzeve dhe lenteve si dhe te gjitha materileve qe lidhen me zhvilimin dhe permbushjen e veprimitarise se saj. Për më tepër shoqëria mund të veproje si kontraktor i përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskencionin e saj të vetëm mund të kontrakttoi palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha punimeve. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit te shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave. Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoi drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesemarrje në shoqëri të tjera shiptarë apo të huaja, si edhe të hyje ne marrëdhene kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose te huaj.”
- **Behet :** “Kryerjen e konsultave oftalmologjike, diagnostikime te patologjive oftalmike ku perfshihen: patologjite korneale dhe glaucoma, patologjite retinale dhe neuro-oftalmologjia, patologji te oftalmologjise pediatrike dhe okuloplastika. Gjithashtu do te kryhet ekzaminimi dhe trajtimi i anomalive

*rekraktive, korrigjim me syze, lente kontakti (te buta ose rigide), injesione intravitreale, dhe injeksione peri/retrobulbare, perdonimi i Cross-Link (CXL). Do te kryhen ekzaminime imazherike si: autorefraktometria dhe biomikroskopja, topografia korneale, microperimetria, tomografia retinale, Eko A/B dhe Angiografia me Fluoresceine. Do te kryhen nderhyrje kirurgjikale me anestezi topikale per trajtimin e kataraktes, pterygiumit dhe chalasion ose me anestezi gjenerale per trajtimin e obstruksioneve te duktusit nazolakrimale.”*

**VENDOSI:**

1. Te miratoje propozimin per ndryshimin e pershkrimit te aktivitetit.
2. Te autorizoj zotin Fluked Terpo me ID. I80801053M per te kryer procedurat e pershtatshme prane QKB.

ORTAK I VETEM

ALBERT LULA



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Albert Lula" above a stylized, swooping flourish that likely represents the suffix "Lula".